



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova

Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Kosovska Akademia za Javnu Bezbednost / Kosovo Academy for Public Safety

**RREGULLORE (AKSP) NR. 06/2025 PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA NGACMIMI DHE NGACMIMI
SEKSUAL NË AKADEMINË E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE**

**REGULATION (KAPS) NO. 06/2025 ON PREVENTION AND PROTECTION FROM HARASSMENT AND SEXUAL
HARASSMENT IN THE KOSOVO ACADEMY FOR PUBLIC SAFETY**

**UREDBA (KAJB) BR. 06/2025 O PREVENCIJI I ZAŠTITI OD UZNEMIRAVANJA I SEKSUALNOG UZNEMIRAVANJA
U KOSOVSKOJ AKADEMIJI ZA JAVNU BEZBEDNOST**

AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE Në mbështetje të nenit 14 paragrafit 1, nën-paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, nxjerr: RREGULLORE (AKSP) NR. 06/2025 PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA NGACMIMI DHE NGACMIMI SEKSUAL NË AKADEMINË E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE Neni 1 Qëllimi 1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të parandalojë dhe të trajtojë rastet e ngacmimit dhe ngacmimit seksual në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (në vijim AKSP), duke garantuar një ambient të sigurt, të lirë dhe të barabartë për vijuesit, personelin akademik, jo-akademik dhe administrativ. Ajo synon të forcojë respektimin e barazisë gjinore, mos-diskriminimit, parimit të ndershmërisë dhe etikës profesionale, duke mbrojtur dinjitetin e secilit anëtar të komunitetit akademik.	KOSOVO PUBLIC SAFETY ACADEMY Pursuant to Article 14, paragraph 1, subparagraph 1.2 of Law No. 04/L-053 on the Kosovo Academy for Public Safety, the General Director of the Kosovo Academy for Public Safety, issues: REGULATION (KAPS) NO. 06/2025 ON PREVENTION AND PROTECTION FROM HARASSMENT AND SEXUAL HARASSMENT IN THE KOSOVO ACADEMY FOR PUBLIC SAFETY Article 1 Purpose 1. The purpose of this regulation is to prevent and address cases of harassment and sexual harassment at the Kosovo Academy for Public Safety (hereinafter KAPS), by guaranteeing a safe, free and equal environment for attendees, academic, non-academic and administrative staff. It aims to strengthen respect for gender equality, non-discrimination, the principle of honesty and professional ethics, while protecting the dignity of each member of the academic community.	KOSOVSKA AKADEMIJA ZA JAVNU BEZBEDNOST U skladu sa članom 14, stav 1, podtačka 1.2 Zakona br. 04/L-053 o Kosovskoj akademiji za javnu bezbednost, generalni direktor Kosovske akademije za javnu bezbednost, izdaje: UREDBA (KAJB) BR. 06/2025 O PREVENCIJI I ZAŠTITI OD UZNEMIRAVANJA I SEKSUALNOG UZNEMIRAVANJA U KOSOVSKOJ AKADEMIJI ZA JAVNU BEZBEDNOST Član 1 Cilj 1. Svrha ove uredbe je sprečavanje i rešavanje slučajeva uznemiravanja i seksualnog uznemiravanja u Kosovskoj akademiji za javnu bezbednost (u daljem tekstu KAJB), garantovanjem bezbednog, slobodnog i ravnopravnog okruženja za polaznike, akademsko, neakademsko i administrativno osoblje. Cilj joj je jačanje poštovanja rodne ravnopravnosti, nediskriminacije, principa poštenja i profesionalne etike, uz zaštitu dostojanstva svakog člana akademske zajednice.
---	---	---

2. Rregullorja përcakton procedurat, masat disiplinore dhe mekanizmat e raportimit për trajtimin e rasteve të ngacmimit apo ngacmimit seksual, duke siguruar mbështetje institucionale dhe masa efektive ndaj shkelësve. Kjo përbën një instrument të domosdoshëm për kultivimin e frymës së humanizmit dhe gjithëpërfshirjes, si dhe për ruajtjen e reputacionit dhe standardeve më të larta profesionale të AKSP-së. 3. Kjo rregullore është në pajtueshmëri me standardet që promovohen nga Rregullorja në fuqi për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelor dhe Master e Agjencisë së Kosovës për Akreditim. Neni 2 Fushëveprimi Kjo rregullore zbatohet për të gjithë personelin akademik, jo-akademik dhe administrativ të punësuar në AKSP, pavarësisht nga forma dhe lloji i kontratës apo niveli i emërimit, si dhe të punësuarit apo të angazhuarit tjerë, si dhe për vijuesit e saj. Neni 3 Përkufizimet 1. Vend i punës - përfshin:	2. The regulation establishes procedures, disciplinary measures and reporting mechanisms for dealing with cases of harassment or sexual harassment, by ensuring institutional support and effective measures against offenders. This constitutes an indispensable instrument for cultivating the spirit of humanity and inclusiveness, as well as for maintaining the reputation and highest professional standards of KAPS. 3. This regulation is in compliance with the standards promoted by the Regulation in force on the Manual for Accreditation / Reaccreditation and Validation of Higher Education Institutions and Study Programs at Bachelor and Master Level of the Kosovo Accreditation Agency. Article 2 Scope This regulation applies to all academic, non-academic and administrative staff employed at KAPS, regardless of the form and type of contract or level of appointment, as well as to other employees or contractors, as well as to its attendees. Article 3 Definitions 1. Workplace - includes:	2. Uredba utvrđuje procedure, disciplinske mere i mehanizme prijavljivanja za postupanje u slučajevima uznemiravanja ili seksualnog uznemiravanja, obezbeđivanjem institucionalne podrške i efikasnih mera protiv počinitelaca. Ovo predstavlja neophodan instrument za negovanje duha humanosti i inkluzivnosti, kao i za održavanje ugleda i najviših profesionalnih standarda KAJB. 3. Ova uredba je u skladu sa standardima koje promoviše važeća Uredba o Priručniku za akreditaciju/reakreditaciju i validaciju visokoškolskih ustanova i studijskih programa na nivou osnovnih i master studija Kosovske agencije za akreditaciju. Neni 2 Oblast delovanja Ova uredba se primenjuje na sve akademsko, neakademsko i administrativno osoblje zaposleno u KAJB-u, bez obzira na oblik i vrstu ugovora ili nivo imenovanja, kao i na ostale zaposlene ili izvođače radova, kao i na njihove učesnike. Član 3 Definicije 1. Radno mesto - obuhvata:
--	---	--

1.1. hapësirat zyrtare të institucionit (zyrat, korridoret, sallat e takimeve, klasat, bibliotekat, kantinat, oborret etj.); 1.2. ambientet jashtë institucionit, kur aktiviteti është i lidhur me punën (udhëtime zyrtare, trajnime, seminare, vizita studimore, ngjarje të organizuara nga institucioni); 1.3. komunikimin elektronik dhe digjital (email-et zyrtare, rrjetet sociale, grupet e komunikimit online të krijuara për punë); 1.4. çdo situatë tjetër ku ekziston marrëdhënie pune ose hierarkie midis punonjësve apo studentëve dhe stafit. 2. Ambient mësimor dhe akademik – për studentët e AKSP-së nënkupton çdo ambient ku ata realizojnë procesin e studimit, përfshirë sallat e ligjëratave, bibliotekën, laboratorët, hapësirat e praktikës/internshipit, aktivitetet jashtë auditorit të lidhura me programin studimor, si dhe komunikimin elektronik e digjital të lidhur me procesin arsimor; 3. Ngacmim seksual - Ngacmimi seksual përkufizohet si çdo sjellje e natyrës që cenon dinjitetin e të gjitha gjinive, dhe konsiderohet e padëshiruar, e papranueshme, e	1.1. Official spaces of the institution (offices, corridors, meeting rooms, classrooms, libraries, canteens, courtyards, etc.); 1.2. Premises outside the institution, when the activity is related to work (official trips, trainings, seminars, study visits, events organized by the institution); 1.3. Electronic and digital communication (official emails, social networks, online communication groups created for work); 1.4. Any other situation where there is a working relationship or hierarchy between employees or students and staff. 2. Learning and academic environment – for KAPS students means any environment where they carry out the study process, including lecture halls, library, laboratories, practice/internship spaces, extracurricular activities related to the study program, as well as electronic and digital communication related to the educational process; 3. Sexual harassment - Sexual harassment is defined as any behavior of a nature that violates the dignity of all genders, and is considered unwanted, unacceptable,	1.1. zvanični prostori institucije (kancelarije, hodnici, sale za sastanke, učionice, biblioteke, menze, dvorišta itd.); 1.2. prostorije van institucije, kada je aktivnost povezana sa poslom (službena putovanja, obuke, seminari, studijske posete, događaji koje organizuje institucija); 1.3. elektronska i digitalna komunikacija (zvanični imejlovi, društvene mreže, grupe za onlajn komunikaciju kreirane za posao); 1.4. bilo koja druga situacija u kojoj postoji radni odnos ili hijerarhija između zaposlenih ili studenata i osoblja. 2. Akademsko i nastavno okruženje – za studente KAJB-a znači svako okruženje u kojem se odvija proces studija, uključujući predavaonice, biblioteku, laboratorije, prostore za vežbanje/praksu, vannastavne aktivnosti vezane za studijski program, kao i elektronsku i digitalnu komunikaciju vezanu za obrazovni proces; 3. Seksualno uznemiravanje – Seksualno uznemiravanje se definiše kao svako ponašanje koje krši dostojanstvo svih polova i smatra se neželjenim, neprihvatljivim,
---	--	---

papërshtatshme dhe fyese, duke shkaktuar një mjedis pune të frikshëm dhe armiqësor. Ngacmimi seksual përfshin çdo lloj sjelljeje të padëshiruar verbale, jo-verbale apo fizike me natyrë seksuale, e cila ka për qëllim ose ndikon në cenimin e dinjitetit të një personi, veçanërisht duke krijuar një atmosferë kërcënuese, poshtëruese apo denigruese, e cila manifestohet ndër të tjera, me elementët në vijim: 3.1. Çdo kontakt fizik i padëshiruar dhe i drejtpërdrejtë duke filluar nga prekja, përqafimi, puthja, përkëdhelje; 3.2. Sulmet, pengimi apo bllokimi i lëvizjeve ose kontakti i drejtpërdrejtë fizik; 3.3. Kërcënime me kushtëzim të vendit të punës ose ofrimi i benificioneve në punë; 3.4. Përdorimi i emrave abuzivë, ofendimeve, komente denigruese me konotacione seksuale për një person ose një grup të caktuar; 3.5. Komentet me konotacione seksuale në lidhje me veshjet, pamjen etj; 3.6. Shikime të dyshimta, bërja e gjesteve dhe tregimi i fotografive poshtëruese dhe me konotacione seksuale;	inappropriate and offensive, causing an intimidating and hostile work environment. Sexual harassment includes any type of unwanted verbal, non-verbal or physical behavior of a sexual nature, which has the purpose or effect of violating the dignity of a person, in particular by creating a threatening, humiliating or denigrating atmosphere, which is manifested, among others, with the following elements: 3.1. Any unwanted and direct physical contact starting from touching, hugging, kissing, petting; 3.2. Attacks, obstruction or blocking of movements or direct physical contact; 3.3. Threats with job conditioning or offering benefits at work; 3.4. Use of abusive names, insults, derogatory comments with sexual connotations for a person or a certain group; 3.5. Comments with sexual connotations regarding clothing, appearance, etc; 3.6. Suspicious looks, making gestures and showing humiliating and sexually suggestive photos;	neprikladnim i uvredljivim, što izaziva zastrašujuće i neprijateljsko radno okruženje. Seksualno uznemiravanje obuhvata svaku vrstu neželjenog verbalnog, neverbalnog ili fizičkog ponašanja seksualne prirode, koje ima za cilj ili efekat kršenje dostojanstva osobe, posebno stvaranjem preteće, ponižavajuće ili omalovažavajuće atmosfere, što se manifestuje, između ostalog, sledećim elementima: 3.1. Svaki neželjeni i direktan fizički kontakt, počevši od dodirivanja, grljenja, ljubljenja, milovanja; 3.2. Napadi, ometanje ili blokiranje pokreta ili direktnog fizičkog kontakta; 3.3. Pretnje uslovljavanjem posla ili nuđenjem pogodnosti na poslu; 3.4. Upotreba pogrđnih imena, uvreda, pogrđnih komentara sa seksualnim konotacijama za osobu ili određenu grupu; 3.5. Komentari sa seksualnim konotacijama u vezi sa odećom, izgledom itd.; 3.6. Sumnjivi pogledi, gestikuliranje i prikazivanje ponižavajućih i seksualno sugestivnih fotografija;
---	---	---

3.7. Shfaqja e padëshiruar e materialeve - fotografive dhe objekteve me ngjyrimë seksuale; 3.8. Dërgim i mesazheve denigruese me përmbajtje seksuale përmes e-mailit, teksteve dhe postimeve në rrjete sociale ose kanale të tjera të komunikimit. 4. Ngacmim – nënkupton çfarëdo forme të sjelljes së padëshiruar mbi bazat e kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, që ka për qëllim apo që ka për pasojë preken apo shkeljen e dinjitetit të një personi dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, degradues, nënçmues apo fyes. 5. Autoritet kompetent - Autoritet kompetent për shqyrtimin e denoncimeve për ngacmime apo ngacmime seksuale për personelit akademik është Komisioni i Etikës, për personelit tjetër është Komisioni Disiplinor, ndërsa për studentë është Komisioni Disiplinor.	3.7. Unwanted display of materials - photos and objects with sexual overtones; 3.8. Sending derogatory messages with sexual content via email, texts, and posts on social networks or other communication channels. 4. Harassment – means any form of unwanted conduct on the basis of nationality or association with a community, social or national origin, race, ethnicity, color, birth, origin, sex, gender, gender identity, sexual orientation, language, citizenship, religion and belief, political affiliation, political or other opinion, social or personal status, age, family or marital status, pregnancy, maternity, property, health, disability, genetic heritage or any other basis, which has the purpose or effect of touching or violating the dignity of a person and creating an intimidating, hostile, degrading, humiliating or offensive environment.. 5. Competent authority - The competent authority for reviewing complaints of harassment or sexual harassment for academic staff is the Ethics Committee, for other staff it is the Disciplinary Committee, while for students it is the Disciplinary Committee.	3.7. Neželjeno prikazivanje materijala - fotografija i predmeta sa seksualnim prizvukom; 3.8. Slanje pogrdnih poruka sa seksualnim sadržajem putem imejla, SMS poruka i objava na društvenim mrežama ili drugim komunikacionim kanalima. 4. Uznemiravanje – znači svaki oblik neželjenog ponašanja na osnovu nacionalnosti ili povezanosti sa zajednicom, društvenog ili nacionalnog porekla, rase, etničke pripadnosti, boje kože, rođenja, porekla, pola, roda, rodnog identiteta, seksualne orijentacije, jezika, državljanstva, veroispovesti i uverenja, političke pripadnosti, političkog mišljenja ili drugih mišljenja, društvenog ili ličnog statusa, starosti, porodičnog ili bračnog statusa, trudnoće, majčinstva, imovine, zdravstvenog stanja, invaliditeta, genetskog nasleđa ili bilo koje druge osnove, koje ima za cilj ili efekat kršenja ili povrede dostojanstva osobe i stvaranja zastrašujućeg, neprijateljskog, ponižavajućeg, ponižavajućeg ili uvredljivog okruženja. 5. Nadležni organ - Nadležni organ za razmatranje žalbi na uznemiravanje ili seksualno uznemiravanje za akademsko osoblje je Etički odbor, za ostalo osoblje je Disciplinski odbor, dok je za studente Disciplinski odbor.
---	---	--

Neni 4 Parimet e përgjithshme	Article 4 General principles	Član 4 Opšti principi
1. Ngacmimi dhe ngacmimi seksual bien ndesh me parimin e trajtimit të barabartë mbi bazë të gjinisë, seksit dhe identitetit gjinor dhe përbëjnë formë diskriminimi mbi bazë të gjinisë. Si shkelje të të drejtave të njeriut, ato janë të ndaluara dhe duhet të jenë objekt i përgjegjësiive efektive institucionale, si dhe të ndëshkimeve të efektshme, proporcionale dhe parandaluese. 2. Në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm, vijuesit, personeli akademik, jo-akademik dhe administrativ i AKSP-së kanë detyrimin të respektojnë barazinë gjinore, të shmangin çdo formë diskriminimi, të zbatojnë parimin e ndershmërisë, kodin etik dhe të ruajnë reputacionin e AKSP -së, si dhe të kultivojnë e promovojnë frymën e humanizmit dhe gjithëpërfshirjes. 3. Kjo rregullore ka për qëllim ruajtjen dhe promovimin e standardeve më të larta të mësimdhënies dhe mësimnxënies, si dhe krijimin e një ambienti të sigurt dhe të lirë nga çdo formë diskriminimi. Ajo zbatohet për vijuesit, personelin akademik, jo-akademik dhe administrativ, të afërmit e tyre, si dhe për individët e tjerë të evidentuar si pjesë e ambientit arsimor.	1. Harassment and sexual harassment are contrary to the principle of equal treatment on the grounds of gender, sex and gender identity and constitute a form of discrimination on the basis of sex. As a violation of human rights, they are prohibited and should be subject to effective institutional accountability and effective, proportionate and preventive sanctions. 2. In accordance with applicable legislation, the students, academic, non-academic and administrative staff of the KAPS have the obligation to respect gender equality, avoid any form of discrimination, implement the principle of honesty, the code of ethics and maintain the reputation of the KAPS, as well as cultivate and promote the spirit of humanism and inclusiveness. 3. This regulation aims to maintain and promote the highest standards of teaching and learning, as well as to create an environment that is safe and free from any form of discrimination. It applies to students, academic, non-academic and administrative staff, their relatives, as well as to other individuals identified as part of the educational environment.	1. Uznemiravanje i seksualno uznemiravanje su u suprotnosti sa principom jednakog tretmana na osnovu pola, pola i rodnog identiteta i predstavljaju oblik diskriminacije na osnovu pola. Kao kršenje ljudskih prava, zabranjeni su i treba da podležu efikasnoj institucionalnoj odgovornosti, kao i efikasnim, srazmernim i odvrćajućim sankcijama. 2. U skladu sa važećim zakonskim propisima, studenti, akademsko, neakademsko i administrativno osoblje KAJB imaju obavezu da poštuju rodnu ravnopravnost, izbegavaju svaki oblik diskriminacije, primenjuju princip poštenja, kodeks etike i održavaju ugled KAJB, kao i da neguju i promovišu duh humanizma i inkluzivnosti. 3. Ovaj pravilnik ima za cilj održavanje i promociju najviših standarda nastave i učenja, kao i stvaranje bezbednog okruženja bez bilo kakvog oblika diskriminacije. Primenjuje se na polaznike, akademsko, neakademsko i administrativno osoblje, njihove rođake, kao i na druge pojedince identifikovane kao deo obrazovnog okruženja.

Neni 5 Përgjegjësitë e AKSP-së për parandalimin dhe mbrojtjen nga ngacmimi dhe ngacmimi seksual	Article 5 KAPS Responsibilities for Prevention and Protection from Harassment and Sexual Harassment	Član 5 Odgovornosti KAJB-a za prevenciju i zaštitu od uznemiravanja i seksualnog uznemiravanja
1. Anëtarët e personelit akademik, jo-akademik, administrativ dhe studentët duhet të kenë konsideratë për njëri-tjetrin dhe duhet t'i respektojnë kufijtë personal të njëri-tjetrit. 2. AKSP zhvillon dhe harton Planin e Veprimit për parandalimin e rasteve të ngacmimit dhe të ngacmimit seksual dhe mbikëqyr zbatimin e tij. 3. AKSP ndërmerr masa parandaluese që të informojë, edukojë dhe komunikojë me studentët, personelin akademik, jo-akademik dhe administrativ në lidhje me parandalimin dhe sanksionimin e ngacmimit dhe ngacmimit seksual në vendin e punës dhe ambientet arsimore. 4. AKSP i bën të dukshme informatat lidhur me përmbajtjen e kësaj rregulloreje në hapësirat e AKSP-së, njofton studentët, personelin akademik dhe jo-akademik dhe administrativ se ku ushtrohen raportimet për rastet e ngacmimeve dhe ngacmimeve seksuale si dhe edukon mbi masat parandaluese, raportuese dhe hetuese. 5. Informatat për denoncimin dhe raportimin e rasteve të ngacmimit dhe ngacmimit seksual	1. Members of academic, non-academic, administrative staff and students must be considerate of each other and must respect each other's personal boundaries. 2. KAPS develops and drafts an Action Plan for the prevention of cases of harassment and sexual harassment and supervises its implementation. 3. KAPS undertakes preventive measures to inform, educate and communicate with students, academic, non-academic and administrative staff regarding the prevention and sanctioning of harassment and sexual harassment in the workplace and educational facilities. 4. KAPS makes information regarding the content of this regulation visible in KAPS premises, informs students, academic and non-academic and administrative staff of where to report cases of harassment and sexual harassment, and educates on preventive, reporting and investigative measures. 5. Information on denouncing and reporting cases of harassment and sexual harassment	1. Članovi akademskog, neakademskog, administrativnog osoblja i studenti moraju biti obzirni jedni prema drugima i moraju poštovati međusobne lične granice. 2. KAJB razvija i izrađuje Akcioni plan za sprečavanje slučajeva uznemiravanja i seksualnog uznemiravanja i nadgleda njegovu primenu. 3. KAJB preduzima preventivne mere kako bi informisao, edukovao i komunicirao sa studentima, akademskim, neakademskim i administrativnim osobljem u vezi sa sprečavanjem i sankcionisanjem uznemiravanja i seksualnog uznemiravanja na radnom mestu i u obrazovnim ustanovama. 4. KAJB stavlja informacije o sadržaju ovog pravilnika na vidljivo mesto u prostorijama KAJB, obaveštava studente, akademsko i neakademsko i administrativno osoblje o tome gde da prijave slučajeve uznemiravanja i seksualnog uznemiravanja i edukuje o preventivnim, prijavnim i istražnim merama. 5. Informacije o prijavljivanju i izveštavanju slučajeva uznemiravanja i seksualnog

duhet të jenë lehtë të qasshme për studentët edhe në ueb faqet zyrtare, si dhe duhet të përmbajnë informata anonime për këshillën dhe referim te mëtejshëm. 6. AKSP ndërmerr veprime në përputhje me Planin e Veprimit dhe me këtë rregullore dhe zbatohet masa disiplinore në rastet e ngacmimit ose ngacmimit seksual. 7. Pas pranimit të denoncimit nga pala ankuese, AKSP merr masa të menjëhershme sipas kësaj rregullore për ndalimin e vazhdimin të ngacmimit, përfshirë ngacmimin seksual.	should be easily accessible to students, even on official websites, and should contain anonymous information for advice and further reference. 6. KAPS takes action in accordance with the Action Plan and this regulation and applies disciplinary measures in cases of harassment or sexual harassment. 7. Upon receipt of a complaint from the complaining party, KAPS takes immediate measures in accordance with this regulation to prevent the continuation of harassment, including sexual harassment.	uznemiravanja treba da budu lako dostupne studentima na zvaničnim veb stranicama i treba da sadrže anonimne informacije za savetovanje i dalje upućivanje. 6. KAJB preduzima mere u skladu sa Akcionim planom i ovim pravilnikom i primenjuje disciplinske mere u slučajevima uznemiravanja ili seksualnog uznemiravanja. 7. Po prijemu žalbe od strane koja se žali, KAJB preduzima hitne mere u skladu sa ovim pravilnikom kako bi sprečio nastavak uznemiravanja, uključujući seksualno uznemiravanje.
Neni 6 Edukimi për parandalimin e ngacmimeve dhe ngacmimeve seksuale 1. AKSP siguron mjedis, i cili përkrah dijen, praktika dhe politika, për të eliminuar ngacmimin, ngacmimin seksual dhe të gjitha format e diskriminimit. 2. AKSP mund të nxjerrë udhëzues sipas nevojës për sqarimin e procedurës për parandalimin e diskriminimit, ngacmimit dhe ngacmimeve seksuale. 3. AKSP obligohet t'u ofrojnë qasje të lehtë studentëve, personelit akademik, jo-akademik dhe administrativ, në informata dhe aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat e trajtojnë	Article 6 Education for the prevention of harassment and sexual harassment 1. KAPS provides an environment that supports knowledge, practices and policies to eliminate harassment, sexual harassment and all forms of discrimination. 2. KAPS may issue guidelines as needed to clarify the procedure for preventing discrimination, harassment and sexual harassment. 3. KAPS is obliged to provide students, academic, non-academic and administrative staff with easy access to information and legal and sub-legal acts that address harassment	Član 6 Obrazovanje za sprečavanje uznemiravanja i seksualnog uznemiravanja 1. KAJB pruža okruženje koje podržava znanje, prakse i politike za eliminisanje uznemiravanja, seksualnog uznemiravanja i svih oblika diskriminacije. 2. KAJB može izdati smernice po potrebi kako bi razjasnio postupak za sprečavanje diskriminacije, uznemiravanja i seksualnog uznemiravanja. 3. KAJB je dužan da studentima, akademskom, neakademskom i administrativnom osoblju obezbedi lak pristup informacijama i zakonskim i

